

VENDIM
Nr.328, datë 31.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË
INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 shkronja “c”, 20, shkronjat “e” e “g” dhe 29, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statuti i nëpunësit civil” dhe të neneve 78-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, paragrafi i fundit i pikës 2 të kreut I dhe paragrafi i fundit i pikës 1 të kreut II, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha